

RELACION PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 96/2016 PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR

Projektligji që paraqitet në Kuvend për shqyrtim dhe miratim parashikon krijimin e një mekanizmi për rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së magjistratëve, që bëjnë pjesë në sistemin e drejtësisë, në raport me veprat penale që kryhen në fushën e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Është fakt evident që në Shqipëri është konstatuar për shumë vite mungesa e hetimit dhe gjyqimit të plotë dhe të shpejtë të veprave penale me një natyrë të tillë dhe shpesh në raportet e OSCE/ODIHR edhe në raportet e organizatave ndërkombëtrare është evidentuar një e metë e tillë serioze.

Projektligji synon të krijojë një mekanizëm, krahas mekanizmave të tjerë në praktikë, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e magjistratëve për hetimin dhe gjyqimin e këtyre veprave penale. Mekanizmi i propozuar është në drejtim dhe funksion të përgjigjshëm dhe përgjigjshmërisë individuale profesionale të këtyre magjistratëve. Këtë gjë projektligji e realizon nëpërmjet amendimit të nenit 77 të ligjit nr 96/2016 sipas të cilit në burimet e vlerësimit të magjistratit, krahas elementëve të tjerë, do të përfshihen edhe dosjet e hetimit ose, sipas rastit, të gjyqimit për krimet që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve dhe për të cilat Kodi Penal parashikon në minimum dënimin me jo më pak se një vit burg, duke përfshirë, për dosjet gjyqësore, edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video, të cilat janë hetuar ose gjykuar nga magjistrati.

I njëjti mekanizëm shtohet edhe në burimet e vlerësimit të veprimtarisë së kryetarit të prokurorisë, vlerësimi i të cilit, krahas elementëve të tjerë ligjore, do të mbështetet edhe për dosjet e hetimit që drejton për krimet që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve dhe që Kodi Penal parashikon në minimum dënimin me jo më pak se një vit burg, të cilat janë hetuar nën drejtimin e tij.